



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 22.14.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
PRIZRENIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme..... | 4 |
| I. Hyrje | 5 |
| II. Opinioni i auditimit..... | 6 |
| III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara | 7 |
| IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar..... | 8 |
| V. Pasqyrat financiare..... | 9 |
| V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm | 9 |
| V.2 Cilësia e informatave | 10 |
| VI. Realizimi i Buxhetit | 10 |
| VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)..... | 10 |
| VI.2 Shpenzimet..... | 13 |
| VI.3 Subvencionet dhe transferet..... | 15 |
| VI.4 Pasuritë dhe Borxhet..... | 16 |
| VII. Kontrolli mbi menaxhimin..... | 18 |
| VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm | 18 |
| VII.2 Auditimi i Brendshëm..... | 18 |
| VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës | 20 |
| Shtojca I. Komentet e Prizrenit dhe përgjigjja e ZAP-it..... | 21 |
| Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit..... | 21 |

Lista e shkurtesave

| | |
|-------|--|
| AB | Auditimi i Brendshëm |
| AP | Auditori i Përgjithshëm |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| ISA | Institucioni Suprem i Auditimit |
| KA | Komiteti i Auditimit |
| LAB | Ligji për Auditimin e Brendshëm |
| LMFPP | Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë |
| LPP | Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007, përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010. |
| LLVTH | Llogaria e Vetme e Thesarit |
| MEF | Ministria e Ekonomisë dhe e Financave |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| OE | Operatori Ekonomik |
| ONISA | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI) |
| PVF | Pasqyrat Vjetore Financiare |
| SIMFK | Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës |
| SNISA | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) |
| SNK | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit |
| SNKSP | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS) |
| UA | Udhëzim Administrativ |
| ZAP | Zyra e Auditorit të Përgjithshëm |
| ZKA | Zyrtar Kryesor Administrativ |

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogarit e arkëtueshme është jo i plotë dhe i pasaktë;

Po ashtu komuna nuk kishte shpalos pagesat nga palët e treta në mënyre adekuate.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, dhe duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2009 janë dhënë 12 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, katër janë adresuar plotësisht, ndërsa tetë janë në proces të implementimit.

Rekomandimi ynë kryesor është që Kryetari i komunës duhet të propozojë një pako masash për përmirësimin e mëtutjeshëm menaxheria brenda Komunës, dhe të sigurojë rishikimin e sistemit të kontrollit.

Ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Adresimin e gjithave rekomandimeve të dhënë të vitit 2009 dhe 2010.
- Hartimin e Pasqyrave Vjetore Financiare në përputhje të plotë me Udhëzimet e nxjerra nga Thesari;
- Rritjen e Kontrolleve të duhura dhe të mjaftueshme në lidhje me përcjelljen e procesit të harmonizimit të të hyrave ndërmjet departamenteve dhe drejtorisë së financave;
- T'i kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit të proceseve të prokurimit dhe kontrolleve lidhur me prokurimet;
- Vendosijen e kontrolleve të duhura në lidhje me menaxhimin e detyrimeve të pa paguara dhe shpalosjen korrekte të detyrimeve kontigjente;

- Të merren masa të menjëhershme mbi menaxhimin e pasurive; dhe
- Njësi funksionale të Auditimit të Brendshëm.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i Komunës i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e Komunës së Prizreni të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) 16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Prizrenit.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse Pasqyrat Financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Prizrenit. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës së Prizrenit, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testimet substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën .

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogarit e arkëtueshme është jo i plotë dhe i pasaktë;

Po ashtu komuna nuk kishte arritur ti shpalos pagesat nga palët e treta.

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtueshme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të PVF për vitin 2009 janë dhënë 12 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, katër janë adresuar plotësisht siç janë:

- Avanset për udhëtime zyrtare janë menaxhuar në mënyre adekuate;
- Komiteti i auditimit funksional;
- Dokumentacioni mbështetës i të hyrave vetjake është në ruajtje; dhe
- Raporti i pranimit të mallrave para certifikimit të pagesave.

Ndërsa të tjerat janë në proces të implementimit. Rekomandimet në proces janë:

- Forcimi i kontrolleve rreth menaxhimit të të hyrave nga prona publike;
- Harmonizimet mujore në mes të të dhënave të drejtorive, regjistrave të bankës dhe librit kryesor (departamentit të Thesarit).
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- Regjistrimi i plotë dhe i saktë i obligimeve financiare të pa paguara dhe raportimi i tyre në Pasqyrat vjetore Financiare;
- Regjistrimi i pasurisë jo financiare, siç kërkohet me UA Nr. 21/2009; dhe
- Njësia e Auditimit të brendshëm të jetë më funksional.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, kanë shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Me këtë rast, ne shprehim shqetësimin tonë për të gjitha rekomandimet e pa adresuara.

IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve

Në euro (€)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Rishikuar | Buxheti Final | Buxheti i shpenzuar 2010 | Buxheti i shpenzuar 2009 |
|---|-------------------|------------------------|------------------------|--------------------------|--------------------------|
| Grandi i Qeverisë – Buxheti | 20,947,394 | 21,449,846 | 21,661,557 | 21,119,192 | 18,745,000 |
| Të hyrat vetjake | 4,964,235 | 4,964,235 ¹ | 5,227,091 ² | 3,768,470 | 4,667,000 |
| Donacionet e vendit | 0 | 0 | 382,777 | 284,122 | 318,000 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 0 | 456,899 | 58,000 | 70,000 |
| I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve | 25,911,629 | 26,414,081 | 27,728,324 | 25,229,784 | 23,800,000 |
| Rrogat dhe pagat | 10,415,849 | 10,902,631 | 11,250,649 | 11,129,125 | 10,112,000 |
| Mallra dhe shërbime | 2,208,223 | 1,936,908 | 2,475,979 | 2,340,381 | 2,074,000 |
| Shpenzimet komunale | 557,764 | 658,898 | 658,898 | 616,553 | 614,000 |
| Subvencionet dhe transferet | 350,000 | 350,000 | 382,002 | 372,004 | 348,000 |
| Investimet Kapitale | 12,379,793 | 12,565,644 | 12,960,796 | 10,771,721 | 10,652,000 |
| Rezervat | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| II. Gjithsej shpenzimet | 25,911,629 | 26,414,081 | 27,728,324 | 25,229,784 | 23,800,000 |

Gjatë vitit 2010 komuna ka shpenzuar 25,229,784 € apo 91% nga buxheti i aprovuar. Pjesa më e madhe e buxhetit është realizuar për investime kapitale dhe paga e mëditje. Krahasuar me vitin 2009, shpenzimet e përgjithshme të Komunës janë rritur për 9.4%.

Ne kolonën e tretë të tabelës shihet se buxheti final ishte 27,728,324€ Buxheti final ishte për 1,816,695€ më i lartë se sa buxheti fillestar. Diferenca arsyetohet me faktin se të hyrat vetjake dhe donacionet e jashtme deri më tani nuk kanë qenë të parashikuara në procesin e përpilimit të buxhetit, ndërsa pjesa tjetër e diferencës nga fondi i përgjithshëm ka të bëjë me buxhetin e rritur për paga të aprovuar në nivelin qeveritar.

¹ Të hyrat e planifikuar për vitin 2010

² Të hyrat e pranuar në 2010. Prej tyre 792,658€ janë të hyra të barta nga viti 2009 ndërsa 4,434,433€ janë të hyra të mbledhura në vitin 2010.

Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2010 ishte 2,499,029€ Ne kemi vërejtur tendencën e rritjes së shpenzimeve të investimeve kapitale në fund të vitit financiar. Vetëm në tre mujorin e fundit ishin shpenzuar deri në 33% të kësaj kategorie.

Konkluzion

Sipas vlerësimit tonë komuna ka shpenzuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2010 sipas parashikimeve dhe limiteve të përcaktuara nga Kuvendi i Kosovës.

Niveli më i ultë i zbatimit të programit për investime kapitale tregon se ekzistojnë dobësi në proceset e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime kapitale të komunës.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Forcimin e kontrollit të brendshëm lidhur me shfrytëzimin e buxhetit në pajtim me planifikimin e bërë; dhe
- Forcimin e kontrollit në planifikimin, menaxhimin dhe monitorimit të investimeve kapitale për të arritur efikasitet më të madh në realizimin e kontratave në afatin e caktuar.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Komuna nuk ka arritur të përgatisë P/F plotësisht sipas UA nr. 16/2010 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore;
- P/F janë nënshkruar me 31 janar 2011 nga Zyrtari kryesor administrative dhe zyrtari kryesor financiar;
- P/F janë dorëzuar në MEF/Thesar në datën 18 shkurt 2011 për shkak të ndryshimeve, në nenin 10 kolonën C (Realizimi) pas afatit të paraparë.,
- P/F janë përgatitur në kopje fizike dhe formë elektronike; dhe
- Janë dorëzuar raporte financiare tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010, por vetëm për Shpenzimet Kapitale.

V.2 Cilësia e informatave

Draft Pasqyrat Financiare të komunës të përgatitura më 31.01.2011 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010 nuk ishin në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.16/2010. Ato përmbanin keq deklarime dhe ishin të pasakta, prandaj në gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga Komuna që Pasqyrat Financiare të versionit fillestar të korrigjohen.

PVF të komunës pas kërkesës sonë, gjatë procesit të auditimit, janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar, mirëpo prapë disa gabime kanë mbetur të pa korrigjuara në PVF finale.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit:

- Shënimin 27, Përmbledhja e pasurive jo financiare në pasqyra financiare nuk është plotësuar sipas U/A 16/2010;
- Në shënimin 28, të arkëtueshmet nuk janë prezantuar; dhe
- Nuk janë prezantuar dhe shpalosur pagesat nga palët e treta dhe informatat shtesë për të pagueshmet, të arkëtueshmet apo pasuritë tjera jofinanciare.

Konkluzioni

Mos prezantimi i të arkëtueshmeve dhe pagesave nga palët e treta në pasqyrat financiare ka ndikim negativ në raportimin e plotë dhe si të tilla pasqyrat i bën të mangëta dhe jo plotësisht të besueshme.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se me rastin e hartimit të pasqyrave financiare, të gjitha informatat e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ të fundvitit janë përfshirë, duke i trajtuar edhe shpalosjet e nevojshme që nuk janë pjesë e kategorive buxhetore; dhe
- Se në mungesë të njohurive të mjaftueshme për hartimin e pasqyrave, menaxhmenti duhet të mundësoj trajnime shtesë stafit.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat e pranuar në vitin 2010, sipas Thesarit ishin 5,227,091€ Prej tyre, të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 ishin 792,658€ ndërsa të hyrat e mbledhura për vitin 2010 ishin në shumë prej 4,434,433€

Këto të hyra janë mbledhur kryesisht nga leje ndërtimi, tatimi në pronë, të hyra nga taksa administrative, të hyrat nga participimi në arsim dhe shëndetësi, si dhe të hyrat tjera.

Në vijim do të prezantohen gjetjet kryesore për disa mostra të marra për testim nga kategoria e të hyrave.

Mos harmonizimi i gjendjeve në llogaritë bankare dhe librin kryesor

Të hyrat vetjake në llogari bankare të komunës janë prezantuar në shumën prej 4,055,104€³ ndërsa sipas Thesarit 4,046,404€ Zyrtarët e Komunës nuk ishin në gjendje që të shpjegojnë mosbarazimin prej 8,700 € në mes llogarisë bankare dhe librit kryesor.

Regjistrimi në kodet e gabuara

Gjatë auditimit ne kemi gjetur që të hyrat nga certifikatat e lindjes dhe certifikatat martesore, janë regjistruar në një kod ekonomik.

Mungesa e regjistrave për të hyrat vetjake

Përveç të hyrave nga licencat për biznese, menaxhmenti i komunës nuk mban regjistra ose lista për të gjithë borxhlinjtë në lidhje me taksat e ndryshme. Kjo ia vështirëson komunës mbledhjen efektive të të hyrave nga taksat.

Tatimi në pronë

Program i ri i tatimit në pronë ende ka mbetur i pa kompletuar si rezultat i problemeve të cilat janë paraqitur në MEF. Ky program ende nuk jep informata dhe qasje zyrtareve të komunës të rishikojnë dhe t'i monitorojnë të gjitha arkëtimet nga tatim paguesit.

Në bazë të dhënave nga Thesari mbi tatimin pronë të Komunës së Prizrenit, është konstatuar se shuma e faturimeve është 1,125,454€ ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2010 ishte 1,167,778€ Borxhet e bartura nga vitet e kaluara janë 3,157,065€

Taksa në firmë

Sipas raporteve të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, shuma e inkasuar është 542,788€ Borxhi i pa inkasuar për këtë vit është 270,642€

Po ashtu, gjatë auditimit kemi vërejtur se zyrtarët komunal, në emër të taksave për firmë gjatë vitit 2010, kanë shpërndarë në terren 1797 vërejtje me shkrim për bizneset që kanë obligime ndaj Komunës, mirëpo asnjëherë nuk janë marrë masa tjera ndëshkuese në bazë të Rregullores mbi tarifa dhe ngarkesa Nr. 01/011-4099, me të cilën parashihet dënim me të holla prej 200 € si dhe marrjes së Lejes së punës të lëshuar nga Kuvendi Komunal.

³ Në llogarit bankare të komunave nuk përfshihen gjobat. Ato derdhen në LLVTH

Mosbarazim i të hyrave në mes drejtorive

Kemi vërejtur se përkundër raportimit mujor të të hyrave, ekziston një mos barazim në mes drejtorisë së financave dhe departamentit të shërbimeve publike. Në bazë të të dhënave të drejtorisë së financave obligimet e subjekteve për marrjen në shfrytëzim të tregjeve janë 176,071€ ndërsa në bazë të evidencave të departamentit të shërbimeve publike, obligimet janë 231,438€

Dështim në inkasimin e të hyrave

Gjatë auditimit kemi vërejtur në një rast ku drejtorja e shërbimeve publike i ndërprente kontratën operatorit ekonomik për shkak të mospagimit të borxhit në vlerë prej 25,601€ si borxh i qirasë. Mirëpo, më vonë, e njëjta drejtori bënë shkelje duke lidhur kontratë të re me të njëjtin OE edhe pse kishte obligime të papaguar ndaj komunës.

Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër

Në këtë drejtori kemi vërejtur mos harmonizim të U/A të nxjerr nga ana e Agjencisë Kadastral dhe Rregullores së Brendshme të Komunës së Prizrenit në ofrimin e shërbimeve që ofron kjo drejtori. Si ndryshim kemi rastin të ndarja e parcelave mbi 0.50h, ku sipas rregullores mbi tarifat, ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale është 100€, ndërsa sipas U/A të Agjencionit Kadastral për të njëjtin shërbim është 50€ ndryshimet e tilla kemi në një numër të konsiderueshëm të shërbimeve të kryera.

Konkluzioni

Mungesa e evidencave të sakta mbi të arkëtueshmet, kontrollet jo të duhura dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat dhe sistemin e faturimit rrisin rrezikun që të hyrat të keq prezantohen. Komuna nuk ka aplikuar mekanizma të duhur kontrolli mbi gjendjen e të hyrave. Në një situatë të tillë nuk është e mundur të bëhen barazimet mbi të hyrat sipas evidencave kontabël dhe sistemit të faturimit. Mungesa e harmonizimeve të sakta minon besueshmërinë e shifrave dhe shpie në pasiguri se çka paraqesin ato të dhëna.

Në kushte të tilla, Komuna nuk është në gjendje të planifikoj buxhet të besueshëm dhe të sigurt, gjithashtu nuk raporton shkallë të arkëtueshmerisë, apo të përcjellë mbledhjet e të hyrave vetjake në baza kohore.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Të gjitha të hyrat të regjistrohen sipas kodeve ekonomike përkatëse, sepse praktika e tanishme nuk mundëson pasqyrimin e drejtë të gjendjes mbi të hyrat;
- Harmonizimet e duhura në mes të llogarisë bankare dhe Thesarit;
- Të bëhen harmonizime në baza mujore në mes departamentit të faturimit dhe të kontabilitetit;
- Të forcoj kontrollet dhe angazhimin në mbledhjen e borxheve të mbetura; dhe
- Të vendos dhe ekzekutoj aplikimin e penaleve në pagesat e vonuara nga ana e klientëve.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

Ne kemi testuar 124 mostra që mbulojnë 6,950,315€ të pagesave të shpenzimeve të udhëhequra përmes procedurave të prokurimit. Ne kemi vërejtur se komuna ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik:

Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve dhe sigurimit të ekzekutimit të kontratës

Ne kemi vërejtur se kontrata e nënshkruar pa zotim të plotë të fondeve ishin si me poshtë:

Ne rastin “Ndërtimi i shkollës fillore” në fshatin Nashec të Prizrenit është bërë zotimi i mjeteve në vlerë prej 215,000€ ndërsa kontrata është lidhur në vlerë prej 347,322€ Me vërejtjen e paraqitur në kontratë është cekur se puna mund të kryhet vetëm deri në shumën e zotuar. Kjo vërejtje nuk është përfillur. Po ashtu, kontrata nuk ka pasur sigurim të ekzekutimit.

Ne rastin “Ndërtimi i kanalizimit të Hasit”, kontrata është në vlerë prej 108,432€ kurse zotim i mjeteve ishte 5,000€

Ne rastin “Furnizimi me kubëza dhe zhavorr” për rrugët në fshatrat Pllanjanë-Jabllanicë, kontrata është lidhur në vlerën prej 80,985€ kurse të zotuar ishin 25,853€ Po ashtu, kësaj kontrate i mungonte edhe sigurimi i ekzekutimit.

Lidhja e kontratave për projektet të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me Planin e Prokurimit Publik

Në disa raste kemi vërejtur se disa nga kontratat e nënshkruara nuk kanë qenë të parapara me planin e prokurimit si:

- “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës” në fshatin Zhur, vlera e kontratës 526,210€
- “Ndërtimi i rezervarit të ujës-jellësit” në fshatin Hoqë të qytetit të Prizrenit në vlerë prej 33,928€ dhe
- “Ndërtimi i trotuarit” në rrugën “Shaip Spahiu” në vlerë prej 146,982€

Mos kryerja e punëve sipas afatit me kontratë

Te lënda “Ndërtimi i elementeve të betonit dhe kanalizimit” Aleks Buda në Prizren, në vlerë prej 111,404€ kemi vërejtur vonesa në kryerjen e punëve për 45 ditë.

Konkluzioni

Rastet e përshkruar më lart flasin për dështime në proceset e kontrollit të brendshëm nga ana e komunës. Investimet për projekte kapitale nuk menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente. Kontrollat e brendshme të komunës nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme së procedurat e prokurimit zbatohen në pajtim me kërkesat ligjore. Dështimet në zbatimin dhe kontrollin e procedurave të prokurimit tregojnë një mungesë të përgjithshme të një qeverisjeje të mirë në fushën e prokurimit.

Rekomandimi 4

Ne Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Të kryhet një analizë e plotë e procedurave të tanishme të prokurimit;
- Ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e projekteve dhe në asnjë rast Komuna nuk duhet të hyjë në obligime pa pasur mbulesë financiare;
- Garancioni i ekzekutimit të kontratave të aplikohet në të gjitha projektet. Penalet gjithashtu janë përlllogaritur me rastin e vonesave në realizimin e projekteve;
- Janë realizuar kërkesat e përgjithshme të LPP mbi planifikimin e prokurimit, duke i planifikuar me kohë të gjitha aktivitetet vjetore; dhe
- Aplikohen masa relevante administrative kur procedurat janë të keq-menaxhuar.

2.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti për paga dhe mëditje ishte 11,250,649€ ndërsa sipas shënimeve në P/F në këtë kategori janë shpenzuar 11,129,125€ ose 99% e buxhetit të aprovuar.

Më tutje, kemi vërejtur se Komuna kishte paguar 40 punëtor të arsimit përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, e jo nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Një shumë prej 110,703€ janë prezantuar në P/F si obligime të pa paguara në emër të pagave dhe mëditjeve në departamentin e arsimit. Ne kemi gjetur 10 raste kur kontratat e punës nuk përputhen me shumatat e paguara.

Konkluzioni

Kjo mënyrë e trajtimit të pagesave shtesë po përsëritet prej vitit në vit dhe nuk është transparente. Mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimit nga autoritetet përkatëse ose mungesa e dokumentacionit në dosje mund të sjellë deri te pagesat që nuk janë në përputhje me Ligjin dhe rregulloret. Kjo minon bazën për monitorimin dhe kontrollin e shpenzimeve dhe e bën kualitetin e informacionit në PVF më të dobët.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Të gjitha pagesat e të punësuarve do të bëhen nga kategoria paga dhe mëditje e jo nga kategoria mallra dhe shërbime; dhe
- Të gjitha pagesat e pagave bëhen në pajtim me shumatat sipas kontratave të personelit.

VI.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për kategorinë e subvencioneve ishte 382,002€ ndërsa sipas shënimeve në P/F në këtë kategori janë shpenzuar 372,004€ ose në masën 97%.

Përdorimi i Kategorisë së Subvencioneve në komunë nuk është edhe aq transparent. Subvencionet që i paguhet një njësie të përcaktuar apo një ndërmarrje private duhet të bazohet në një marrëveshje zyrtare ndërmjet organizatës buxhetore dhe pranuesit të subvencionit. Gjatë testimit të kësaj kategori kemi konstatuar:

Shpenzim i pa planifikuar i Subvencionit

Subvencioni në shumë prej 2,173€ i shpenzuar në departamentin e bujqësisë nuk ishte i planifikuar. Kjo shumë është shpenzuar nga alokimet e mjeteve për programet tjera.

Në dosje mungon informata e ecurisë mbi realizimin e projektit

Sipas memorandumit me Nr-01/165 i datës 30.10.2009 për realizimin e projektit të përbashkët të Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve për vendosjen e tabelave informative të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, komuna ka participuar në shumë prej 3,000€ Memorandumi parasheh që shfrytëzuesi i subvencionit obligohet që ta informojë komunën për ecurinë e realizimit të projektit. Në dokumentacionin lidhur me këtë pagës ne nuk na është prezantuar një informacion i tillë.

Mungesa e projekteve

Në aplikacionet e bëra nga shfrytëzuesit e subvencioneve, si parakusht i përfitimit të subvencionit ishte ekzistimi i projektit. Ne kemi vërejtur se projektet që kanë munguar në dosje kanë qenë te subvencionimi i projektit “Vizitat sistematike në të gjitha shkollat” në shumën prej 2,000€

Konkluzioni

Mos zbatimi i kritereve dhe rregullave financiare të përcaktuara nga ana e komunës nuk ofron siguri se paraja publike është duke u shpenzuar në mënyrën më të mirë.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Janë përgatitur plan-projekte të mirëfillta dhe të gjitha projektet që subvencionohen kanë arsyshmëri;
- Do të bëjë vlerësimin adekuat të të gjithë aplikusve të këtyre projekteve dhe të respektohen parimet bazë të cilat janë të përcaktuara sipas kritereve të parapara; dhe
- Shfrytëzuesi i subvencionit duhet t'i dorëzoj raporte të qarta menaxhmentit të komunës mbi mënyrën e shpenzimit të subvencioneve.

VI.4 Pasuritë dhe Borxhet

4.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Menaxhmenti i komunës nuk ishte në gjendje të ofroj ndonjë dëshmi të saktë mbi numërimin fizik të mjeteve më 31 Dhjetor 2010 dhe si pasojë nuk ishte e mundur të bënim një verifikim të të dhënave në kontabilitet me të dhënat e numërimit fizik. Ne kemi vërejtur se Kryetari i Komunës ka formuar komisionin për inventarizim dhe komisionin për vlerësim të pasurisë me datën 13.01.2011, mirëpo kjo çështje është në proces të vlerësimit të pasurive. Akoma nuk disponojmë raporte mbi punën e kryer nga ana e këtij komisioni, ndërsa inventarizimi

është përfunduar, por jo në afatin e paraparë kohor. Për shkak të natyrës së këtyre të dhënave, Komuna nuk ishte në gjendje që:

Përfundimisht, në fund të procedurës numëruese të kryej një barazim të hollësishëm të të dhënave që rezultojnë nga numërimi si dhe të të dhënave prezente në kontabilitet.

Konkluzioni

Mos respektimi i UA 21/2009 nuk siguron menaxhim efektiv të pasurive qeveritare dhe rrit rrezikun që pasurit të keqpërdore.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj që :

- Të përfundoj një regjistër gjithë përfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve si dhe të njëjtat të regjistroj dhe të shpalos në pasqyrat financiare të vitit vijues; dhe
- Të kryejë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistrin të pasurisë.

4.2 Borxhet

Menaxhimi i detyrimeve

Sipas shënimeve të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit 2010, komuna ka shpalosur detyrime të pa paguar në vlerë prej 3,488,830€ Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2011.

Ne po ashtu kemi rishikuar borxhet të cilat janë paraqitur në P/F dhe kemi gjetur se si borxh është paraqitur kontrata pa numër në vlerë prej 9,700€ Kontrata e paraqitur si obligim i pa paguar nuk ishte ende e nënshkruar ndërmjet palëve kontraktuese.

Menaxhimi i detyrimeve kontingjente

Janë gjetur fatura të paguara në vitin 2010 të cilat nuk ishin prezantuar në pasqyrat financiare në vitin 2009 si detyrime kontingjente. Detyrimet në shumë prej 3,535€ 5,799€ dhe 1,599€ janë paguar drejtpërdrejt nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore, sipas të cilave ishte dhënë urdhër që të paguheshin shumat e caktuara më lartë.

Konkluzioni

Me qëllim të dhëniës se një prezantimi të saktë të pozitës së saj financiare në fund të vitit, Komuna duhet (mes tjerash) të prezantoj një shifër të saktë për detyrimet – duke përfshirë edhe detyrimet kontingjente. Për ta bërë këtë komuna duhet të ketë sisteme për regjistrimin e saktë të detyrimeve dhe për identifikimin e detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Kontabilitetit disponon me të gjitha informatat për detyrimet e papaguara dhe këto detyrime janë të prezantuara drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare, ashtu siç kërkon UA; dhe
- Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues.

VII.Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Kapitujt e përshkruar më lart flasin për dobësi evidente të kontrollit të brendshëm të Komunës, dhe rishikimi funksional i sistemit ka nevojë të bëhet. Për pasojë, kontrollet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i Komunës për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve dhe parregullsive nuk kanë funksionuar mjaftueshëm.

Konkluzioni

Në përgjithësi konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar është jo adekuat. Kontrollet ekzistuese nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se objektivat e menaxhmentit përmbushen në mënyrë të mjaftueshme.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj;

- Përmirësimin e nivelit të kontrollit financiar dhe kontrollet e përgjithshme, duke i adresuar rekomandimet e këtij raporti, së bashku me implementimin e atyre të dala nga viti paraprak.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Komuna e Prizrenit ka të themeluar NjAB që menaxhohet vetëm nga Drejtor i Auditimit të Brendshëm. NJAB ka përgatitur planin vjetor të auditimit, duke paraparë që të realizohen gjashtë auditime. Gjatë këtij vitit kishte arritur t'i kryej pesë raporte; katër raporte të parapara me planin vjetor ndërsa një raport ad-hoc me kërkesë të kryetarit.

Raportet të cilat janë kryer nga NJAB kishin si objektive vlerësimin e të hyrave nga tatimi në pronë, menaxhimin e shpenzimeve në departamentin emergjencave, menaxhimin e pasurisë

komunale, procedurat e prokurimit për gjashtë mujorin e parë 2010 dhe menaxhimin e shpenzimeve në departamentin e Arsimit.

NJAB ka staf të limituar për të kryer auditime cilësore.

NJAB nuk i ka përcjell veprimet korigjuese të ndërmarra nga menaxhmenti lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Gjatë auditimit kemi vërejtur se komiteti i auditimit në Komunën e Prizrenit, pas këshillimeve në fazën paraprake të auditimit, tani është bërë më funksional. Ky komitete ka mbajtur gjithsej dy takime, ku ka shqyrtuar raportet e auditorit dhe po ashtu finalizimin e planit të veprimit të drejtorive përkatëse për plotësimin e rekomandimeve të dhënë nga ZAP dhe AB.

Konkluzioni

NJAB ka staf të limituar në raport me buxhetin e Komunës. Njëkohësisht prej katër raporteve është vërejtur se vetëm dy prej tyre kanë plan të zbatimit të rekomandimeve.

Rekomandimi 10

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Funksionalizimin e NJAB në kuptimin e numrit të mjaftueshme të auditorëve;
- Se të gjeturat dhe rekomandimet të adresohen si duhet dhe të ndërmerren masa në korigjimin dhe zbatimin e tyre;
- Të fuqizoj edhe më shumë rolin e Komitetit të auditimit; dhe
- Se komiteti i auditimit do të mbaj takime të rregullta pune për të siguruar mbikëqyrje të duhur të planeve dhe rezultateve të auditimit.

VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës

Konkluzioni i përgjithshëm

Dobësitë e identifikuar në kuadër të këtij raporti, në lidhje me kualitetin e informatave, realizimin e buxhetit, sistemin e prokurimit publik, menaxhimin e detyrimeve dhe menaxhimin të pasurive kanë shpie në konkluzionin të përgjithshëm se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prizrenit.

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj;

- Rishikimin e sistemit të kontroleve si dhe të propozoj një pako masash për përmirësim të mëtutjeshme menaxheriale brenda komunës.

Shtojca I. Komentet e Prizrenit dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjë përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranura të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opionioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opionionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.